



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 20. 1.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

I mbledhjes Konstituive të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Jasmina Zhivković, Mexhide Mjaku- Topalli, Mytaher Haskuka, Etem Arifi, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paqaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit- UNICEF.

Pjesëmarrësit e tjerë: Suzan Novobërdali-këshilltare, Lejla Selimi-OSBE, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Raba Gjoshi-YIHR, dhe Basri Berisha-IAP.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 01;
3. Miratimi i vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit;
4. Listimi i detyrave që dalin nga Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën, për 2014;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.12.2014

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.12.2014, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

Kryetarja, fillimisht i njoftoi anëtarët e Komisionit se Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij iu ka kaluar mandati dhe duhet marrë vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, pasi që në legjislaturën e kaluar të Kuvendit, asnjëri nga kandidatët e mundshëm nuk ka arritur të marrë numrin e mjaftueshëm të votave. Fillimisht, zgjidhet Avokati i Popullit dhe pastaj duhet të vazhdohet me procedurat edhe për zgjedhjen e zëvendësve.

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati debat.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 1 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, nr. 04-V-049, në mbledhjen e mbajtur më 20 janar 2015, unanimisht miratoi këtë

VENDIM

1. Shpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit;
2. Konkursi publikohet në mediat e shkruara dhe elektronike, në gjuhën shqipe, boshnjake, angleze, serbe dhe turke;
3. Afati për paraqitjen e kandidatëve është 20 (njëzet) ditë;
4. Kushtet e konkursit janë të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 6;
5. Ngarkohet Administrata e Kuvendit për publikimin e konkursit dhe për veprimet tjera procedurale, konform Rregullores.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

4. Listimi i detyrave që dalin nga Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën, për 2014

Kryetarja, tha se Raporti i Progresit iu adresohet institucioneve me detyra nga fusha të ndryshme. Për Komisionin tonë janë disa sfida, sepse duhet t'i avancojmë të drejtat e njeriut në Kosovë. Në këtë mbledhje e kam parë të nevojshme që të prezantojmë në pika

të shkurta materien që do të ballafaqohemi nga ky raport dhe me detyrat që dalin nga Strategjia Legjislative e Qeverisë, ku do të hartojmë bashkërisht planin e punës dhe do t'i rendisim detyrat me prioritet për t'i shqyrtuar.

Salihe Mustafa, theksoi se në planin e punës që do ta bëjë Komisioni, do të bazohet dhe do t'i listojë detyrat, sipas planit legjislativ të Qeverisë, sepse Raportin e Progresit e ka edhe Qeveria dhe do të bazohet në të. Raporti i Progresit cek që Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji kundër diskriminimit dhe Ligji për barazinë gjinore, duhet të shqyrtohen në pako. Ky raport, si anë pozitive përmend se nuk kanë vërejtur shkelje të drejtave të njeriut nëpër burgje, por ka vërejtje tjera.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se e ka lexuar këtë pjesë të raportit dhe mendon se duhet të jepet edhe një hapësirë kohore, që të japim propozimet konkrete për detyrat që dalin. Është cekur tri herë në raport që ligjet për Avokatin e Popullit, kundër diskriminimit dhe për barazi gjinore, duhet të shqyrtohen në pako, për avancimin e të drejtave të njeriut.

Është vlerësuar lart në Raportin e Progresit se në institucionet korrektuese nuk ka keqtrajtime sistematike të burgosurve. Gjithashtu, përmendet se është bërë burgu i sigurisë së lartë, por është e nevojshme të plotësohet me staf për efikasitetin e tij. Ajo tha se i intereson të dijë se a është kthyer ndonjë raport nga sekretari i OKB-së, lidhur me peticionin për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë dhe sa është punuar në regjistrimin e numrit të këtyre grave.

Etem Arifi, tha se kjo pjesë e raportit që është ofruar është e mangët, sepse nuk janë përfshirë të drejtat e minoriteteve, kur të bëjmë listimin e detyrave në planin e punës, duhet koordinuar punët për një të ardhme më të mirë dhe raporti i ardhshëm të jetë më pozitiv.

Kryetarja sqaroi se nuk kanë paraqitur prezantim të raportit për komunitetet, pasi që kjo bie në fushëveprimin e Komisionit për Komunitete dhe Kthim.

Teuta Haxhiu, dihet që në vitin e kaluar në Kuvend, nuk është miratuar Raporti i Avokatit të Popullit, të sqarohet se në këtë vit a do të miratohen dy raportet, ai i vitit 2013, dhe pastaj, raporti për vitin 2014.

Sa i përket Raportit të Progresit, do ta analizojmë dhe me shkrim do t'i paraqesim propozimet tona dhe do t'i listojmë në plan të punës, detyrat e dala nga ky raport.

Propozoi që Komisioni të kërkojë nga Qeveria, që në takimet e para që do t'i ketë Qeveria e Kosovës me qeverinë e Serbisë në Bruksel, të diskutohet çështja e personave të pagjetur.

Mytaher Haskuka, tha se po ndërlidhem me planin e punës së Komisionit, ku përveç Raportit të Progresit, duhet dhënë prioritet Strategjisë Legjislative të Qeverisë dhe Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit, sepse ka të bëjë me të drejtat e njeriut në Kosovë. Propozoi që Ligji për përgjimet, të shqyrtohet edhe në këtë Komision, pasi që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe ky ligj duhet plotësuar sipas direktivave të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Kryetarja, tha se ka biseduar me kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian dhe ka kërkuar që kur të jetë në shqyrtim Projektligji për përgjimet, të jetë prezent edhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, e cila është njoftuar se projektligj i është kthyer Qeverisë, njëzëri.

Valdete Bajrami, pasi që jam nënkryetarja e parë e Komisionit për Integritet Evropian, po ndërlidhem sa i përket Projektligjit për përgjimet, sot i është kthyer Qeverisë, pasi që ka shumë mangësi, mbi 50% e projektligjit kërkohet të korrigjohet dhe në momentin që një ligj duhet të ndryshohet 50%, kërkohet që të sillen një projektligj i ri. Sa i përket Raportit të Progresit, tha se çdoherë ka pasur kritika të ashpra në drejtim të Kosovës në përmbushjen e të drejtave të minoriteteve. Në këtë raport, kërkohet që të forcohet Institucioni i Avokatit të Popullit.

Ajo tha se ligji për gratë e dhunuara, është miratuar në vitin 2014 dhe mund të marrim me mend sa gruaja e tillë më ndoshta nuk është në mesin tonë dhe nuk kanë mundur t'i gëzojnë ato të drejta që ua njeh ligji. Ka disa grupe të veçanta të shoqërisë që kërkojnë kujdesin nga ana e jonë. Po ashtu, ky Komision prioritet duhet dhënë edhe çështjes së personave të pagjetur.

Kujtim Paqaku, tha se Raporti i Progresit është i bazuar në pesë fusha. Propozoi që në planin e punës të vendosen prioritetet dhe të fillohen aktivitetet e para të këtij Komisioni.

Pra, të fillohet me të drejtat e njeriut të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian për të drejtën e punësimit, pasi që 0.01% janë të punësuar në institucionet e Kosovës në 15 vitet e fundit.

Duhet të kontaktojmë edhe me fondin për të drejtat humanitare që do të na kishte ndihmuar shumë për personat e pagjetur.

Kryetarja, tha se nga ky debat po vërehet angazhimi i secilit që të japë kontributin e vet, ndërsa janë disa çështje që neve na interesojnë, por janë kompetencë e dikujt tjetër, prandaj do të ndihmojmë për aq sa mundemi, por obligim mund të jetë edhe për ndonjë komision tjetër.

Ne do të kemi edhe agjendën legjislative të Qeverisë, dokumentet e plotësuar, dhe shumë shpejt, do t'i vendosim prioritetet e Komisionit në planin e punës.

4. Të ndryshme

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se sot nga shoqëria civile, në mënyrë simbolike, ka pranuar peticionin e qytetarëve për shtrenjtimin e rrymës dhe do të ndiqen procedurat e nevojshme për shqyrtimin e këtij peticioni, të cilin e kanë nënshkruar afër 33 mijë qytetarë.

Si Komision, në të ardhmen, do ta formojmë një grup punues për shqyrtimin e peticioneve.

Mexhide Mjaku-Topalli, më intereson ta di, a ka ndonjë kalendar se ku kanë mbetur punët e papërfunduara të komisionit paraprak. Ajo propozoi që Komisioni të ketë një takim urgjent me Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur dhe pastaj të fillohet me punët tjera konkrete.

Kryetarja, tha se fillimisht kemi dashur të njoftohemi me sfidat, me të cilat ballafaqohemi dhe pastaj të gjitha do t'i rendisim në planin e punës.

Ajo, po ashtu, informoi se ka pasur një takim si kryetare e Komisionit, me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur dhe shumë shpejt do të na informojnë me një raport.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

